



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

Nr. _____ prot.

Himarë, më ____ . ____ . 2021

Lënda : Kthim përgjigjeje kërkesës suaj të datës 29.04.2021.

Në përgjigje të kërkesës suaj të datës 29.04.2021 ardhur me postë elektronike, protokolluar në institucionin tonë me nr.1647.prot, datë 30.04.2021, lidhur me kërkesën për informacion për funksionimin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës pranë Bashkisë Himarë. Për sa më sipër po ju përgjigjemi pyetjeve sipas renditjes së bërë në kërkesën tuaj.

1-Sa është numri i njësive të mbrojtjes së fëmijëve që disponon Bashkia Himarë sipas Njësive Administrative ?

Bashkia Himarë në administrimin e saj bashkë me dy Njësitë Administrative disponon vetëm një njësi të mbrojtjes së fëmijës e lokalizuar pranë Bashkisë Himarë e cila mbulon me shërbim edhe dy njësitë.

2-Sa punonjës social janë të punësuar pranë këtyre njësive të mbrojtjes së fëmijëve për të gjitha zonat që përfshihen në Bashkinë Himarë?

Një punonjës social është i punësuar pranë të vetmes njësi të mbrojtjes së fëmijës, atë në Bashkinë Himarë.

3- Sa punonjës social janë për një njësi të mbrojtjes së fëmijës?

Vetëm një punonjës e mbulon njësinë e mbrojtjes së fëmijës.

4-Këto Njësi të Mbrojtjes së Fëmijës a janë të ngritura në çdo Njësi Administrative?

Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës është e ngritur vetëm në Bashkinë Himarë e cila ,mbulon edhe dy njësitë administrative.

5-A është i mjaftueshëm numri i punonjësve social të punësuar në këto Njësi apo ka nevojë për shtimin e tyre për të përballuar punën, për të identifikuar dhe gjurmuar rastet e fëmijëve që janë në rrezik të çfarëdo forme të dhunës ?

Numri i punonjësve social nuk është i mjaftueshëm për sipërfaqen që administron Bashkia Himarë duke përfshirë edhe dy njësitë. Duke shkaktuar vështirësi në identifikimin dhe gjurmimin e rasteve të fëmijëve që janë në rrezik për të qënë viktimë të mundshme të çfarëdo forme të dhunës.

6- Sa është fondi që ka shpenzuar Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në vitin 2019 dhe 2020 apo strukturat e tjera që merren me menaxhimin e rastit të fëmijëve në nevojë të abuzuar apo ngacmuar seksualisht?

Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës për vitin 2019-2020 ka harxhuar një fond prej 800.000 lekësh në vit për menaxhimin e rasteve të trajtuara.

7-Sa mund të shpenzohet për menaxhimin e një rasti ku një fëmijë është abuzuar apo ngacmuar seksualisht dhe kërkon ndihmën e punonjësve të mbrojtjes së fëmijës?

Për të menaxhuar një rast të një fëmije të abuzuar duhen minimalisht 30.000 lekë duke marrë parasysh edhe shërbimin e transportit dhe ekspertët e jashtëm që do të marrin pjesë në rastin e trajtuar.

8-A disponojnë punonjësit social infrastrukturën e nevojshme materiale dhe financiare për identifikimin, parandalimin, dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve të dhunuar?

Punonjësit social që punojnë me identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin e rasteve me fëmijët e dhunuar disponojnë infrastrukturën e nevojshme të materialeve informuese dhe protokollat e menaxhimit të rasteve pasi këto vihen në dispozicion nga instancat e duhura që iu vijnë në ndihmë njësisë së mbrojtjes së fëmijës. Infrastruktura financiare është e pa mjaftueshme për të menaxhuar rastet si duhet duke plotësuar çdo nevojë të fëmijës dhe familjes së tijë.

9- Sa janë rastet e fëmijëve të dhunuar, abuzuar apo ngacmuar seksualisht gjatë 8 viteve të fundit për zonat ku Bashkia Himarë vepron, ku janë identifikuar apo parandaluar të abuzohen nga strukturat për mbrojtjen e fëmijës dhe Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës?

Gjatë 8 viteve të fundit numri i rasteve të abuzuara me të miturit është 6.

10- Në 6 njësi administrative që ka Bashkia, sa njësi për mbrojtjen e fëmijës po funksionojnë si dhe sa punonjës social janë punësuar?

Bashkia Himarë ka vetëm dy Njësi Administrative në administrimin e saj dhe jo gjashtë siç e keni ju informacionin. Se sa është numri I punonjësve social të punësuar për mbrojtjen e fëmijës e gjeni përgjigjen tek pyetja 3.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro